

FORMULAR PËR SYLLABUS TË LËNDËS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë
Titulli i lëndës:	Kujdesi infermieror te të sëmurët internistikë
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2 L + 3 LP + 5 CP)+ 25 ore vet mesim ne total per semester)
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Në lokalet e Degës Infermieri dhe Mami
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr Aurora Bakalli
Detajet kontaktuese:	Në lokalet e Degës Infermieri dhe Mami
Përshkrimi i lëndës	<p>Moduli përfshinë mësimet teorike dhe praktikën klinike në të sëmurët me sëmundje internistike</p> <ul style="list-style-type: none">• Studentët do të mësojnë nga ligjeratat dhe ushtrimet praktike lidhur me njohuritë bazike për diagnostikimin, menaxhimin dhe njohuritë e detajuara të kujdesit infermieror për sëmundjet internistike, duke përfshirë sëmundjet kardiologjike, pulmologjike, reumatologjike, gastroenterologjike, endokrinologjike, hematologjike, nefrologjike.
Qëllimet e lëndës:	<p>Studentët do të mësojnë t'i njohin dhe performojnë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Vështërsitë në frymëmarrje, çrregullimet cirkulatore si dhe sëmundjet tjera internistike; eliminimi; gjendja e ushqyeshmërisë; ushqimi enteral/parental; teknikat mjekësore: injektimi dhe infuzioni intravenoz, injektimi intramuskular, injektimi subkutan; kateterizimi urinar; dhembja dhe trajtimi i dhembjes; kujdesi për lëkurën dhe plagët; administrimi i barërave dhe vrojtimi i efekteve të barërave/efekteve anësore; koordinimi/puna ekipore; vrojtimit, inspektimet, matjet, vlerësimet dhe kujdesi specifik infermieror në sëmundje të ndryshme internistike; dokumentimi; trajtimi dhe informimi; planifikimi për lirim të të sëmurit nga kujdesi hospitalor; ambienti infermieror, parimet higjienike dhe masat e sigurisë; metodat shkencore të bazuara në fakte për infermieri; kujdesi infermieror ibazuar në fakte për praktikën klinike; hulumtimi i informatave me përqëndrim në infermierinë e bazuar në fakte.

<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p><i>Me përfundimin e lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • kuptojnë rëndësinë e punës ekipore dhe koordinimit; • përshkruajnë dhe konkretizojnë kuptimin e intervenimeve dhe problemeve infermierore: <ul style="list-style-type: none"> - në vështërsitë në frymëmarrje dhe çrregullimet cirkulatore, si dhe sëmundjet tjera internistike - në eliminim (jashtëqitje dhe urinim) - në marrjen e ushqimit - në lidhjen me gjumin e pacientit dhe aktivitetet - në rast të dhembjes dhe lirimit nga dhembjet - në kujdesin e plagëve - në lidhje me kateterin venoz periferik, urinar etj. - në monitorimin e të sëmurëve me sëmundje të ndryshme: metodat e observimit, monitorimit, vlerësimit dhe regjistrimit • Përshkruajnë <ul style="list-style-type: none"> - sëmundjet e zemrës, enëve të gjakut, sistemit respirator, veshkëve, lukthit, mëlçisë, gjakut, nyjeve, gjëndrave etj. - diagnozën, trajtimin mjekësor përfshirë farmakologjik dhe transfuzionin - dallimet në moshë dhe gjini në raport me diagnozën dhe trajtimin <p>Gjykimi dhe qasja</p> <p>Pas kompletimit të këtij moduli, studenti do të jetë në gjendje të</p> <ul style="list-style-type: none"> - menaxhojë të sëmurët dhe të japë informata në mënyrë profesionale - të tregojë empati me qasje profesionale - të kuptojë përvojën e të sëmurit dhe përvojat e kujdesit infermieror dhe sëmundjeve - përcaktojë prioritetet klinike në kujdesin infermieror - aspektet etike për kujdesin ndaj njerëzve - vetë vlerësimi i dijes dhe aftësive - të vlerësojë aftësinë e të sëmurëve për vetë-kujdesje në mënyrë që të implementojë ndërrimet në stilin e jetesës - vlerësimi i ndikimit të familjarëve në prognozën dhe kualitetin e jetës së të sëmurit - metodat e punës infermierore - dallimin në mes të njohurive të bazuara në fakte dhe përvojës së vërtetuar
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	3	15	45
Punë praktike	5	15	75
Kollokuiume, seminare, prezentime			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	12.5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Totali			175h/ 7 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Organizimi i mësimit teorik dhe praktik (me metoda bashkëkohore ndërvepruese; punë seminarike, punë në grupe të vogla).		
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja dhe aktiviteti..... 10% Prezantimi i temes.....20% Kuize.....20% Prezantimi perfundimtar10% Provimi final40% Gjithsej100% %		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Boon A.N., Colledge R.N, Walker B.R., Hunter J.Davidson’s Principles and Practice of Medicine, 20 th Edition, International Edition, 2006. 2. Kumar P, Clark M. Clinical Medicine, 6 th Edition, International Edition, 2005, 3. Grup Autoresh. Parimet e Mjekesise se Pergjithshme. Tirane, 2002. 4. Longo DL, Fauci AS, Kasper DL, Hauser SL, Jameson J, Loscalzo J. edsl. Harrison’s Principles of Internal Medicine, 20th. New York, NY: McGraw-Hill; 2018.		
Literatura shtesë:	1. Papadakis M, McPhee S, Rabow M. Current medical diagnosis and treatment, 59th edition: McGraw-Hill; 2019.		
Plani i dizejnuar i mësimit:			

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Ekzaminimi subjektiv, objektiv dhe metodat ndihmëse të aparatit respirator, si dhe kujdesi infermieror; Bronkitet dhe bronktolitet. Asthma bronkiale dhe bronkiti asthmatik; Emfizema pulmonare; Bronkiektazitë; Insuficienca respiratore; ARDS
Java e dytë:	Edema pulmonare; Gangrena, absesi dhe infarkti pulmonar; Pleuritet; T.B.C pulmonar ; Pneumotoraksi; Ca pulmonar; Edukimi i pacientit me sëmundje respiratore kronike.
Java e tretë:	Ekzaminimi subjektiv, objektiv dhe metodat ndihmëse të aparatit kardiovaskular, si dhe kujdesi infermieror. Ethet reumatike dhe veset e fituara te zemrës Sëmundjet e valvulës mitrale. Sëmundjet e valvulës aortale
Java e katërt:	Miokarditet, perikarditet, endokarditet; Insuficienca kardiake;. Cor- pulmonale; Çrregullimet e ritmit të zemrës; Angina pectoris; Infarkti i miokardit, Hipertensioni arterial; Edukimi i pacientit me çrregullime kardio vaskulare.
Java e pestë:	Sëmundjet kryesore reumatizmale: ethet reumatike; artrozat, spondiliti ankilozant; artriti reumatoid; sëmundjet sistemike (lupusi eritematoz sistematik, dermatomioziti/poliartriti, skleroza sistmike etj.)
Java e gjashtë:	Ekzaminimi subjektiv, objektiv dhe metodat ndihmëse të aparatit gastrointestinal, si dhe kujdesi infermieror; Ezofagiti; GERD; Ulçera Peptike; Hemoragjitë gastro-intestinale; Kolit Ulçeroz; Neoplazitë e kolonit.
Java e shtatë:	Sëmundje të gojës; Sëmundjet e ezofagut (djegiet, strikturat, trupat e huaj në ezofag dhe kanceri i ezofagut). Sëmundjet e lukthit (gastritet, ulçerat, kanceri i lukthit).
Java e tetë:	Sëmundjet e mëlçisë (ciroza e mëlçisë, ekinokoku i mëlçisë, absesi i mëlçisë dhe hepatotoksiciteti medikamentoz, kanceri i heparit); Sëmundjet e kolicistës dhe rrugëve biliare (kolicistitet, koleliazat); Pankreatitet.
Java e nëntë:	Sëmundjet e zorrëve (enteritet, malabsorbimi, sëmundjet inflamatore të zorrëve); Hepatitet; Edukimi i pacientit më çrregullime të traktit gastrointestinal.
Java e dhjetë:	Ekzaminimi subjektiv, objektiv dhe metodat ndihmëse të aparatit urinar, si dhe kujdesi infermieror; Sindromi nefritik dhe nefrotik; Infeksionet urinare.
Java e njëmbëdhjetë:	Sëmundjet e veshkave dhe të rrugëve urinare: (glomerulonefriti akut dhe kronik, pielonefritet, nefrolitiazat, cistitet, nefropatia gravidarum); Insuficienca renale akute dhe kronike. Edukimi i pacientit me çrregullime të traktit urinar.

<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Procedurat diagnostike në hematologji; Principet e përgjithshme të hematopoiezes; Semundjet e qelizës amë hematopoetike: Semundjet e Eritrocitit, Semundjet beninje dhe malinje të granulociteve.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Crregullimet akute dhe kronike të limfociteve; Crregullimet e hemostazes. Edukimi i pacientit me çrregullime hematologjike.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Sëmundjet e gjendrave endokrine: Sëmundjet e tiroides; Sëmundjet e gjendrave suprarenale dhe të hipofizës; Diabeti mellitus dhe diabeti insipid; hiperglikemia dhe hipoglikemia. Edukimi i pacientit me çrregullime endokrinologjike.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Reaksionet medikamentoze; Shoku anafilaktik; Sëmundja e serumit; Urtikaria; Edema Quincke; Infeksione parazitare: helmintozat, askaridet, enterebiozat, trikiuris, hymenolepis nano, lambioza, leishmanioza.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët janë të obliguar të mësimin teorik dhe praktik në përputhje me rregulloret e lëshuara nga Universiteti i Prishtinës dhe rregullorja për studime themelore e Fakultetit të Mjekësisë. Studentët duhet t'i përmbahen edhe rregullave tjera si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë. • T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitete akademike; • Të sillen mire si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos diskredituar Universitetin. • Të respektojnë të gjitha rregullat e vendosura nga njësi akademike ku organizohet mësimi